

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin**Prill, 2016*

Një vizitë e veçantë në selinë e SBASHK-ut

Përfaqësuesi i BE-së lavdëron përkushtimin dhe arritjet e SBASHK-ut



Pasi ka marrë shumë informacione për punën e përkushtuar të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë dhe për angazhimin konkret për të evokuar në amandamentimin dhe ndryshimet pozitive të ligjeve që lidhen me arsimimin dhe të punësuarit në këtë sektor me rëndësi të veçantë, kryesuesi i grupit të Projektit të BE-së për harmonizimin e legjislacionit të Kosovës në fushën e punës me legjislacionin e BE, z. Bohuslov(faqe 4)

Libri për autorin e himnit turk shkoi në vendlindjen e tij
SBASHK-u vizitoi shkollën "Mehmet Akif"
në Shushicë të Istogut



Në Simpoziumin shkencor në Tiranë sindikata më e madhe turke e arsimit ... (faqe 5)

SBASHK-u përgëzon
FSASH-in në 25 vjetorin e themelimit

Forcohet bashkëpunimi mes dy sindikatave të arsimit

Federata e Sindikatave të Arsimit Shqiptar (FSASH) ka organizuar një takim solemn me rastin e kremtimit të 25 vjetorit....(faqe 7)

Intervistë me mësuesin dhe veprimtarin sindikal z.Kadri Thaçi

SBASHK-u ishte dhe mbetet familje e madhe në shërbim të arsimit

Kadriu gëzon respekt nga të gjithë në SBASHK. Ai është krenar që një jetë të tërë ia ka kushtuar arsimimit të brezave dhe përmirësimit të kushteve të jetës së ... (faqe 3)

SBASHK-u ofron zbritje çmimesh anëtarëve të vet edhe në Turqi

Marrëveshja me "Sierra Tourism" me kushte e çmime shumë të volitshme



Me qëllim që të shoh nga afër kushtet që ofrohen për pushim dhe rekreacion ... (faqe 5)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Zemra e madhe e mësuesit



Një trajnim i organizuar për dialogun social me mësime të mësimdhënës nga shkollat “Isa Boletini” dhe “Kadri Bistrica” ma mundësoi që të bashkëbisedojmë gjatë e shtruar me mësime të mësimdhënës dhe këtyre dy vatrave arsimore shqipe nga Veriu i Kosovës. Më la përshtypje forca e tyre intelektuale dhe përkushtimi për arsimimin e edukimin e brezave në atë pjesë të atdheut tonë. Këta njerëz të mëdhenj , që me krenari them se janë kolegët tanë, vazhdojnë me sakrificat.

Të rrezikuar vazhdimisht nga tekat e urrejtjes serbe dhe pa pasur as kushte elementare për udhëtim deri në shkollë e as kushte pune ata nuk dorëzohen. Kjo është zemra e madhe e mësuesit. Ata nuk ndahen nga nxënësit e tyre as në kohë furtunash e as kur prishet moti. Zemra e madhe e mësuesit e mban gjallë këngën e bukur shqipe, fjalën e shkruar dhe e bën të bie me zërin e dashur zilen e shkollës.

Këta njerëz janë heronjtë e gjallë të kohës dhe shteti ynë duhet të jetë më afër tyre. Ata duan që ta ndjejnë mbrojtjen dhe dorën e ndihmës së merituar të shtetit të Kosovës. Shpresoj se kjo do të ndodh shpejt sepse të punësuarit në këto dy shkolla kanë zemër të madhe të mësuesit.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimit sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me mësuesin dhe veprimtarin sindikal Kadri Thaçi

SBASHK-u ishte dhe mbetet familje e madhe në shërbim të arsimit



Kadriu gëzon respekt nga të gjithë në SBASHK. Ai është krenar që një jetë të tërë ia ka kushtuar arsimimit të brezave dhe përmirësimit të kushteve të jetës së banorëve të vendlindjes së tij. Ka marrë shumë mirënjohje për punë dhe arritje. Ai veçon mirënjohjet

nga shkolla, DKA-ja, MASHT-i, por me krenari të veçantë flet për mirënjohjen nga përfaqësuesja e lartë e SHBA-së, Tina Kajdanova. Krenohet me arritjet e SBASHK-ut dhe apelon që të vazhdohet me unitetin dhe angazhimet.

Arsimimi sot :

Kush është Kadri Thaçi:

Kadriu:

U lindi më 2.07. 1950 në fshatin Sibofc të Kastriotit (Obiliqit). Pasi kreu shkollimin fillestar në Hade, vazhdoi arsimimin tim për mësues në Normalen e Prishtinës. Me misionin e mësuesit për arsimimin dhe edukimin e brezave fillova në fshatin e lindjes. Më vonë mbarova edhe Akademinë Pedagogjike . Isha për një kohë edhe ushtrues detyre i drejtorit të shkollës në Sibovc. Në vitet shkollore 1981-85 punova në shkollën , që tani mban emrin e presidentit historik “Ibrahim Rugova” në Kastriot, kurse nga viti 1985 e deri në pensionimin tim punova në shkollën e fshatit Milloshevë, që mban emrin e atdhetarit “Hasan Prishtina” Më kujtohen shumë ngjarje nga gjithë këto vite. Një nga to është kur isha në vitin e tretë të Normales dhe mua më kishin besuar detyrën që të udhëheq në demonstratat e vitit 1968 me nxënës të vitit të tretë, kurse dy të tjerë të udhëheqin me vitet e katërt dhe pestë. Mua më zunë gjatë demonstratave dhe më dënuan me burgim, që e mbajta në burgun e Prishtinës. Shkolla shqipe në Obiliq kaloi nëpër kohë shumë të vështira. Kur i kemi thënë Jo planeve e programeve serbe, policia e atij shteti okupues erdhi me dhunë enën kërcënimin me armë na dëboi nga objekti shkollor. Ne u organizuam bashkë me popullin dhe vazhduam mësimin nëpër shtëpi –shkolla. SBASHK-u në këtë kohë ka pasur rol kyç në unifikimin e përpjekjeve për ruajtjen e arsimit dhe shkollës shqipe. Kur kthehem prapa në kohë me krenari kujtoj mirënjohjet që shkolla, prindërit, DKA-ja dhe MASHT më ka ndarë për punën dhe

përkushtimin në arsim. E kujtoj me krenari edhe mirënjohjen nga përfaqësuesja e SHBA-ve , pra ambasadorja, Tina Kajdanov. Për angazhimin tim ë vazhdueshëm në realizimin e detyrave për përmirësimin e kushteve të jetës në fshat dhe rrethinë. Kujtoj krenar edhe momentin kur shkolla në të cilën punova kaq vite u shpall më e mira në Kosovë për ambientin e bukur shkollor dhe arritjet tjera e të shumta.

Arsimimi sot :

Fillimet tua në SBASHK?

Kadriu:

Është interesant momenti i zgjedhjes sime në cilësinë e kryetarit të Kuvendit të SAF e SAM të Kastriotit (Obiliqit). U zgjedha dhe u ftua mbledhja e Këshillit Drejtues. Ishte kjo pjesëmarrja ime e parë në një takim të këtij organi, që është më i larti mes dy Kongreseve. Unë erdha në takim dhe aty o mor vendimi unanim që të shkojmë në grevë urie. Ishte grevë e vështirë kjo, por e përballuam dhe dolën fitimtar sepse u plotësuan kërkesat tona. Ka edhe momente të tjera dhe me krenari e them se SBASHK-u u forcua nëpër vite dhe vazhdoi të mbetet në shërbim të arsimit dhe anëtarësisë.

Arsimimi sot :

Si e shihni SBASHK-un sot?

Kadriu:

Me krenari e them se SBASHK-u sot ka arritur unitet të fuqishëm. Kryetari i SBASHK-ut dhe të tjerët veprimtarë po angazhohen maksimalisht dhe janë shënuar arritje. Ky përkushtim dhe afërsia e bashkëbisedat me anëtarësinë kanë bërë që vazhdimisht të shtohet numri i anëtarëve të SBASHK-ut. Arritjet janë të shumta dhe në shumë sfera e gjithnjë në shërbim të anëtarësisë. Të kujtoj me këtë fitoren e madhe në përpjekje për të realizuar 0.5 % për çdo vit shërbimi, pastaj kontratën individual të punës në kohë të pacaktuar, nënshkrimin e 120 e më shumë marrëveshjeve për zbritje çmimesh të shërbimeve për anëtarësinë me biznese e institucione shëndetësore e rekreative dhe shumë e shumë të tjera. Arritjet janë të mëdha dhe po vazhdohet me punë e përkushtim dhe kjo mua më bën të jem krenar dhe do të ndihem anëtar i SBASHK-ut gjatë gjithë jetës sime.

Arsimimi sot :

Jeni i respektuar nga të gjithë në SBASHK, si e keni arritur këtë ?

Kadriu:

Po dhe jam i lumtur që gëzoj këtë respekt. Mirëkuptimi dhe angazhimi i përbashkët dhe i sinqertë ka bërë që kë krijohet respekt i ndërsjellë mes Kryesisë, anëtarëve e veprimtarëve. Kur punohet me përkushtim dhe me sinqeritet krijohet atmosferë mirëkuptimi dhe respekti është i vazhdueshëm dhe kjo bën që puna e aktiviteti të shkojë mbarë dhe të shënohen suksese.

Arsimimi sot :

Porosia juaj për anëtarët e SBASHK-ut

Kadriu:

I porosis gjithë anëtarët e SBASHK-ut që ta ruajnë unitetin dhe respektin e ndërsjellë . Ta ruajmë unitetin ashtu si e kemi edhe emërtimin SBASHK. Kryesinë dhe organet udhëheqëse të SBASHK-ut i ftoj që të vazhdojmë me këtë ritëm të angazhimit dhe me përkushtim në realizimin e kërkesave të anëtarësisë. I ftoj të vazhdojnë edhe me dialogun, por edhe me veprime sindikale , nëse duhet, për të zgjuar nga përgjumja disa qeveri lokale, që ende po hezitojnë të plotësojnë obligimet e tyre për 70 % të shumës së biletave të udhëtimit dhe për tri pagat me rastin e pensionimit të punëtorëve të arsimit. Pra, SBASHK-u të vazhdojë me përkushtimin dhe angazhimet e unë do të vazhdojë të jem pranë ish kolegëve të mi dhe do t'i gëzohem arritjeve të reja.

Gjatë muajit

Një vizitë e veçantë në selinë e SBASHK-ut

Përfaqësuesi i BE-së lavdëron përkushtimin dhe arritjet e SBASHK-ut

Pasi ka marrë shumë informacione për punën e përkushtuar të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë dhe për angazhimin konkret për të evokuar në amandamentimin dhe ndryshimet pozitive të ligjeve që lidhen me arsimimin dhe të punësuarit në këtë sektor me rëndësi të veçantë, kryesuesi i grupit të Projektit të BE-së për harmonizimin e legjislacionit të Kosovës në fushën e punës me legjislacionin e BE, z. Bohuslov Pokorny ka vizituar selinë e SBASHK-ut dhe ka bashkëbiseduar me kryetarin Rrahman Jasharaj dhe menaxherin për financa e këshilltarin për organizim të brendshëm të SBASHK-ut, Ymer Ymeri. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë i kanë treguar përfaqësuesit të BE-së për historikun e SBASHK-ut që nga themelimi në kohët e vështira për Kosovën e deri me sot. Zotëri Pokorny ka vlerësuar lartë angazhimet e SBASHK-ut në realizimin e kërkesave të anëtarësisë dhe në përpjekjet për të ndryshuar pozitivisht ligjin e

punës dhe atë mbi Këshillin Ekonomik Social.



“SBASHK-u e meriton të jetë i pranishëm kudo flitet për çështjet sociale dhe për ligjet nga fusha e punës dhe për atë që lidhet me KEC. Ne si përfaqësues të BE-së bashkëpunimin me ju do ta vazhdojmë edhe duke organizuar tryeza pune deri në finalizimin e legjislacionit të kësaj fushe”, është shprehur z. Bohuslov Pokorny.

Libri për autorin e himnit turk shkoi në vendlindjen e tij

SBASHK-u vizitoi shkollën “Mehmet Akif” në Shushicë të Istogut



Në Simpoziumin shkencor në Tiranë sindikata më e madhe turke e arsimit “Egitim Bir Sen” kishte promovuar gjithë veprimtarinë dhe veprën letrare të Mehmet Akifit Ersojit. Kryetari i kësaj sindikate, z. Ali Yalcin në një takim miqësor me delegacionin e SBASHK-ut kishte shprehur dëshirën që libri për autorin e himnit turk të shkojë edhe në vendlindjen e tij në fshatin Shushicë të Istogut. SBASHK-u kishte premtuar se do ia plotësonin këtë dëshirë z. Aliut dhe librin, në të cilin është edhe emblema e SBASHK-ut, e ka dërguar në shkollën “Mehmet Akif Ersoj” në fshatin e prejardhjes së autorit. Delegacioni i SBASHK-ut i përbërë nga kryetari Rrahman Jasharaj, menaxheri financiar Ymer



Ymeri dhe kryetari i SAF dhe SAM të Istogut z. Muzli Blakaj, fillimisht kanë dorëzuar në bibliotekën e qytetit, në shtëpinë e

kulturës "Adem Jashari" në Istog ekzemplarë të këtij libri.

Pas kësaj kanë vizituar shkollën fillore "Martin Camaj", shkollën e mesme teknike "Mit'hat Frashëri" në Gurrakoc dhe janë pritur nga drejtoritë e këtyre dy shkollave. Edhe në këto dy institucione arsimore delegacioni i



SBASHK-ut ka dhuruar ekzemplarë të librit të Mehmet Akif Ersoy. Delegacioni i SBASHK-ut është ndalur edhe në shkollën “Bajram Curri” në Istog dhe në bashkëbisedë me drejtorin dhe mësimdhënësit këtu u ka dhuruar edhe atyre ekzemplarë të këtij libri. Në fshatin e prejardhjes të Mehmet Akifit, në Shushicë është organizuar ceremoni festive. Drejtori i shkollës që mbanë emrin e Mehmet Akifit, z. Besnik Nimanaj ka falënderuar SBASHK-un duke çmuar librin e Mehmet Akif Ersoy-it si një dhuratë e veçantë. “Mësimdhënësit dhe nxënësit e kësaj shkolle ndihen krenar që janë bashkë-vendas me familjen e Mehmet Akifit. Ne me punë dhe arritje po e mbajmë lartë kujtimin dhe respektin për të”, është shprehur drejtori Nimanaj. Kurse të punësuarit në këtë shkollë kanë përgëzuar SBASHK-un për angazhimet në përpjekje për realizimin e kërkesave të anëtarësisë.

SBASHK-u ofron zbritje çmimesh anëtarëve të vet edhe në Turqi

Marrëveshja me “Sierra Tourism” me kushte e çmime shumë të volitshme



Me qëllim që të shoh nga afër kushtet që ofrohen për pushim dhe rekreacion të anëtarëve nga marrëveshja e lidhur me SBASHK-ut dhe agjensionit turistik “Sierra Tourism” një delegacion i SBASHK-ut ka qëndruar në Antalya të Turqisë. Delegacioni ishte i përbërë nga kryetarët e SBASHK-ut të shtatë regjioneve të Kosovës, kryetari i SUSHK-ut dhe nënkryetarët e SBASHK-ut.

Delegacioni i SBASHK-ut u prit dhe u shoqërua gjatë gjithë kohës nga përfaqësuesit e agjensionit “Sierra Tourism”, z. Ali Kocakaya, z. Feti Gol, z. Ibrahim Ozcan si dhe përfaqësuesi i këtij agjensioni në Kosovë z. Nuhi Mazreku, të cilët mbuluan të gjitha shpenzimet

e këtij delegacioni duke përfshirë udhëtimin, akomodimin si dhe vizitat nëpër hotele. “Mir Amor Hotel”, “Golden Sun Hotel”, “Stella Hotel”, “Bel Point Hotel”, “Zena Resort Hotel”, “Larissa Hotel”, “Balu Himmel Hotel”, “Larissa Kiris Hotel”, “Viev Hotels Kemer”, janë hotele të kategorizuara me tri, katër dhe pesë yje. Personeli i të gjitha hoteleve të cekura më lartë e kanë shoqëruar delegacionin e SBASHK-ut gjatë gjithë kohës së qëndrimit të tyre në Antalia në ambientet e hotelit, duke filluar nga hapësira e gjelbëruar, pishinat e hapura, dhomat, restorantet, baret, saunat, banjot turke, fitness e deri te dhomat e masazheve, në të cilat delegacioni i SBASHK-ut u njoftua për së afërmi me të gjitha kushtet që ofrojnë këto hotele. Vlen të ceket se në këtë vizitë ishte edhe një delegacion i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Shqipërisë. Delegacioni i SBASHK-ut bashkë me nikoqirin kanë përgatitur katalogun dhe ofertat me zbritje çmimesh prej 20 % për gjithë anëtarët e SBASHK-ut sipas marrëveshjes së nënshkruar. Delegacioni i SBASHK-ut ka përcjellë në Kosovë përshtypje shumë të mira nga kjo vizitë dhe pasi ka

parë nga afër se cilat janë kushtet e pushimit në këto hotele është shprehur se kushtet që ofrohen atje dhe çmimet janë mjaft të volitshme për pushuesit. Po botojmë këtu ofertën me hotelet dhe çmimet me zbritje 20%.



PAKETA E CMIMEVE PËR ANËTARËT E SBASHK-ut

7 ditore + all inclusive + bileta aeroplanit + transferet + sigurimi + Prishtinë-Antalya
Antalya-Prishtinë fluturimi direkt

	1 Maj- 30 Maj	31 Maj-30 Qershor	1 Korrik-30gusht
★ ★ ★ Hoteli	271 €	279 €	304 €
★ ★ ★ ★ Hoteli	351 €	383 €	447 €
★ ★ ★ ★ ★ Hoteli	391 €	447 €	479 €

Hotelet

★ ★ ★

Golden Sun

Astoria Hotel

Larissa Beldibi me 4*
(por me çmim të 3*)

Hotelet

★ ★ ★ ★

Sea Gull

Grand Mir-Amor

Larissa Mare Beach

Hotelet

★ ★ ★ ★ ★

Sealife Family

Zena Resort

- Fluturimi i parë është me datë 16 Maj 2016 (e hënë) dhe fluturimet e radhës do të jenë çdo 7 ditë (çdo të hënë)
- Rezervimet duhet të bëhen në Sierra Tourism- Prishtinë, së paku dy javë para fluturimit
- Këto çmime vlejnë edhe për bashkëshortët dhe fëmijët nën moshën 18 vjeçare

Kontaktet për rezervim:

sierratourism-ks@hotmail.com

044 245 790



SBASHK-u përgëzon FSASH-in në 25 vjetorin e themelimit

Forcohet bashkëpunimi mes dy sindikatave të arsimit

Federata e Sindikatave të Arsimit Shqiptar (FSASH) ka organizuar një takim solemn me rastin e kremtimit të 25 vjetorit të themelimit dhe angazhimeve në shërbim të mësimdhënësve të Shqipërisë. Në këtë festë, krahas veprimtarëve sindikalë dhe autoriteteve shtetërore të Shqipërisë ishte ftuar edhe SBASHK-u, që u përfaqësua nga kryetari Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e këshilltari për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri.



Kryetari i FSASH-it, z. Xhafer Dobrusha në fjalën përshëndetëse ka falënderuar mysafirët që kanë ardhur në Tiranë që bashkë me organet dhe veprimtarët e kësaj sindikate t'i gëzohen 25 vjetorit të themelimit. Ai pastaj është ndalur në momentet kyçe të aktiviteteve dhe arritjeve duke përmendur edhe sfidat e shumta me të cilat kjo Federatë është përballur. Kryetari i Komisionit Parlamentar për Arsim në Parlamentin e Shqipërisë, z. Gëzim Polo ka lavdëruar angazhimet e FSASH-it dhe është shprehur se në të ardhmen shteti shqiptar duhet të shtojë komunikimin me sindikatat për të dëshmuar demokracinë dhe dëshirën që çështjet të gjejnë zgjidhje me përmes dialogut. FSASH-in e kanë uruar e përgëzuar për 25

vjetët e angazhimit edhe mysafirë të tjerë.



Në fjalën përshëndetëse në emër anëtarësisë së SBASHK-ut, kryetari Rrahman Jasharaj ka lavdëruar angazhimet e kryetarit Dobrusha për bashkëpunim sa më të madh mes dy sindikatave të arsimit të Kosovës e Shqipërisë. Ai pastaj ka kujtuar se Qeveria shqiptare, populli, po edhe mësimdhënësit u janë gjetur pranë vëllezërve nga Kosova edhe në kohën e zhvendosjes biblike nga dhuna serbe. “Qeveria dhe populli shqiptar hapi dyert e shtëpive dhe zemrat dhe me dashuri vëllazërore na lehtësojë plagët e rënda. Ju kolegë dhe kolege të nderuara hapet dyert e shkollave për mësimdhënësit dhe fëmijët nga Kosova. Na dolët krah në ato ditë tepër të vështira dhe gjithmonë gëzoni respektin tonë. Me sindikatat shqiptare të arsimit ne vazhdojmë bashkëpunimin vëllazëror dhe kemi nënshkruar edhe marrëveshje për angazhimeve të përbashkëta me qëllim që të jeni zë edhe më i fuqishëm sindikal dhe ta shprehim solidaritetin mes nesh kurdo që e kërkon koha dhe situata”, ka thënë veç tjerash në fjalën e tij, kryetari i SBASHK-ut. Delegacioni i SBASHK-ut ka zhvilluar biseda me shumë nga pjesëmarrësit në këtë festë duke këmbyer përvojat për angazhimet sindikale.

SBASHK-u vazhdon aktivitetet me anëtarësinë

Trajnim me kolegët nga Skenderaj, Veriu i Kosovës, Klina, Istogu, Deçani

SBASHK-u po vazhdon me aktivitete e shumta në shërbim të anëtarësisë. Bazuar në Planin Strategjik është duke u realizuar në përpikëri edhe aktiviteti për forcimin e kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social. Në vazhdimësi të këtij përkushtimi po

vazhdojnë trajnimet me mësimdhënës nga Kosova. Në kuadër të këtij aktiviteti janë zhvilluar trajnime me anëtarë të SBASHK-ut nga Skenderaj, Veriu i Kosovës, Istogu, Klina dhe Deçani.



Në trajnimet e ndara me këta kolegë kryetari i SBASHK-ut ka folur për rëndësinë e këtij aktiviteti duke shtuar se ky trajnim është i licencuar nga MASHT dhe se pjesëmarrësit pas testit të arritjeve në ditën e fundit të trajnimit do të marrin certifikata që dëshmojnë për 24 orë trajnim të licencuar. Nga këto trajnime do veçuar atë, në të cilin pjesëmarrës, krahas kolegëve nga Skenderaj, ishin edhe kolegët tanë nga shkollat "Isa Boletini" e Boletinit dhe "Kadri Bistrica" nga Bistrica. Përfaqësuesit e këtyre dy shkollave janë shprehur të kënaqur dhe kanë falënderuar SBASHK-un që çdo herë ishte me ta në përpjekje për të realizuar kërkesat e për të tejkaluar sfidat, që në këtë pjesë të Kosovës nuk janë të pakta. Kryetarët e Kuvendeve të SAF e SAM të Skenderajt, Istogut, Klinës, dhe përgjegjësi për komunë e Deçanit, Ramiz Polaci, Musli Blakaj, Arif Elezaj dhe Afrim Balaj duke folur në emër të anëtarësisë nga komunat e tyre kanë vlerësuar lart angazhimin dhe arritjet e SBASHK-ut.



Ata janë shprehur të sigurt se do të vazhdohet me angazhimet dhe do të shënohen edhe arritje të reja në shërbim të anëtarësisë dhe arsimit të Kosovës. Pjesëmarrësit në këtë trajnim nga shkollat shqipe "Isa Boletini" në Boletin dhe "Kadri Bistrica" e Bistricës në Veriun e Kosovës kanë lavdëruar këtë aktivitet, por edhe angazhimet e SBASHK-ut për të kërkuar që në të ardhmen edhe më shumë të shtohen angazhimet në mbështetje të këtyre shkollave sepse ato punojnë në kushte të vështira dhe se me përkushtim të madh janë duke mbajtur me sukses procesin mësimor, por ndihen se nuk janë të përkrahur sa duhet nga institucionet e shtetit të Kosovës. Ata kanë veçuar se kanë probleme më të shumta se kolegët e tyre në pjesët tjera të Kosovës, duke përmendur edhe problemin aktual të udhëtimit.

Trajneri i licencuar Ymer Ymeri i ndihmuar nga kryetari i SBASHK-ut janë ndalur te "Hyrja në dialogun social", "Funkcionet dhe sfidat e dialogut social", "Dialogu në nivel vendi dhe atë lokal" e tema të tjera që ndërlidhen me dialogun social.



Vlen të theksohet se gjatë gjithë këtyre trajnimeve trajneri ka ditur të nxis bashkëbisedën mes pjesëmarrësve dhe kjo ka bërë që këto aktivitete të jenë të pëlqyera dhe të sjellin edhe rezultate konkrete. Pjesëmarrësit po përcjellin me interesim rrjedhën e trajnimit dhe duke shtruar pyetje e duke dhënë mendime e ide po bëhen pjesë aktive e këtij trajnimit.

Takime të SBASHK-ut me anëtarësinë në Skenderaj , Viti e Istog

Mirënjohje për arritjet , kërkesë që të vazhdohet me angazhimet



SBASHK-u duke vazhduar bashkëpunimin e suksesshëm me GIZ-in ka planifikuar që të nis me ciklin e ri të vizitave nëpër komunat e Kosovës. Ky aktivitet do të fillojë në muajin maj. Në kuadër të këtyre përgatitjeve Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kanë vizituar t Skenderajn , Vitinë dhe Istogun.

Në Skenderaj ata kanë marrë pjesë në mbledhjen e Shoqatës sindikale të Gjimnazit "Hamëz Jashari" për të bashkëbiseduar me anëtarët këtu për çështjet aktuale në arsim. Të punësuarit në këtë shkollë kanë shtruar shumë pyetje nga aktualiteti. Përfaqësuesit e SBASHK-ut Jasharaj e Ymeri kanë dhënë përgjigje në të gjitha pyetjet dhe kanë treguar për arritjet , por edhe për angazhimet konkrete e momentale në SBASHK.

Drejtori i këtij institucioni arsimor dhe të punësuarit këtu lavdëruar SBASHK-un për angazhimet dhe arritjet dhe kanë ofruar edhe ide të reja për angazhimet në të ardhmen. Ata janë pajtuar që duhet vazhduar angazhimet lidhur me Projektligjin lidhur me Statutin e mësimdhënësve të Republikës së Kosovës për vitet shkollore 1989/99 deri në vitin shkollor 1998/99.



Delegacioni i njëti i SBASHK-ut vazhduar këtë angazhim edhe në komunën e Vitisë. Atje kanë marrë pjesë në takimin e Kuvendit të Arsimit Fillor e të Mesëm të kësaj komune. Në hapje të këtij takimi kryetari i Kuvendit të SAF e SAM t ë Vitisë, z. Kemajl Bislmi ka përshëndetur përfaqësuesit e SBASHK-ut dhe drejtorin e DKA-së në këtë komunë, z. Qail Sinani.

Drejtori i DKA-së së Vitisë, z. Sinani në fjalën përshëndetëse ka vlerësuar lartë angazhimin e SBASHK-ut në zgjidhjen e shumë kërkesave të anëtarësisë. Ai ka thënë se bashkërisht duhet shtuar angazhimet që të rishtohet çështja e gjetjes së mundësisë për të shpërblyer mundin e të punësuarve në arsim për vitet 89/99.



Delegacioni i SBASHK-ut ka sjellë në Viti nga dy ekzemplarë për secilën shkollë të veprës së njeriut të madh me prejardhje shqiptare Mehmet Akif Ersoj. Në këtë takim kryetari Kemajl Bislmi ka shtruar para anëtarëve të Kuvendit të SAF e SAM çështjen e zgjedhjeve në këtë komunë. Është thënë se në bazë të Statutit mund të bëhen zgjidhjet për organet e Kuvendit të SAF e SAM në këtë komunë , pasi që deri tani është konsideruar se z. Bismili ka qenë duke kryer këtë detyrë deri në një vendim tjetër. Anëtarët e Kuvendit të SAF e SAM në Viti duke u nisur nga fakti se viti i ardhshëm do të jetë vit i zgjedhjeve në të gjitha Shoqatat sindikale, në Kuvendet e SAF e Sam në të gjitha komunat, në Universitet dhe në Kuvendet e dy niveleve tjera të arsimit kanë vendosur që kryetari Bislmi dhe anëtarët e kryesisë këtu të vazhdojnë angazhimet dhe kryerjen e detyrave deri në vitin 2017 kur edhe këtu , si në gjithë Kosovën , do të bëhen zgjidhje në të gjitha nivelet e organizimit.



Në kuadër të këtyre vizitave kryetari i SBASHK-ut ka vizituar Istogun dhe është takuar me anëtarësinë

edhe në Gjimnazin “ Haxhi Zeka”. Të punësuarit këtu kanë falënderuar kryetarin Jasharaj që i është përgjigjur ftesës së tyre dhe pastaj ata kanë shtruar shumë pyetje lidhur me angazhimet e SBASHK-ut dhe veçmas janë ndalur të çështja e marrëveshjes së rëndësishme lidhur me pensionet e plota në arsim e po ashtu janë interesuar edhe lidhur me çështjen e Projektligjit që ka të bëj me benifitet shtesë për gjithë ata që kanë punuar në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës në vitet 89-99. Kryetari Jasharaj u ka dhënë përgjigje në të gjitha pyetjet e shtruar. Në kuadër të bashkëbisedës është shprehur gatishmëria që edhe ata pak mësimdhënës që ende nuk janë bërë anëtarë të SBASHK-ut këtë do ta bëjnë po tani.